

INFORMACION PËR AZILKËRKUESIT

I dashur azilkërkues

Ke kërkuar nga Finlanda azil (mbrojtje ndërkombëtare). Azilin ose lejen e qëndrimit mund ta marrësh nëse ke nevojë për mbrojtje ndërkombëtare për shkak se në vendin ku jeton ke pësuar fyerje të rënda të të drejtave të njeriut.

Në këtë guidë tregohet sesi çështja jote shqyrtohet pasi ke dorëzuar aplikimin, çfarë të drejtash dhe detyrimesh ke dhe si është jeta në qendrën e pranimit.

RRUGA E SHQYRTIMIT TË AZILKËRKIMIT

Shqyrtimi i aplikimit për azil fillon me hetimin e azilkërkimit. Përgjigju me sinqeritet të gjitha pyetjeve. Gjithashtu paraqit sa më shpejt të jetë e mundur të gjitha dokumentat apo certifikatat që ti disponon. Nëse e argumenton mirë aplikimin që në fillim dhe nuk fsheh fakte të vërteta, çështja jote mund të zgjidhet më shpejt.

Gjatë hetimit, ti ke të drejtë të përdorësh përkthyes të cilin qendra e pranimit ta siguron. Nëse dëshiron mund të kesh edhe ndihmës ligjor apo avokat si dhe të kontaktosh me përfaqësuesin e minoriteteve. Azilkërkuesve nën 18 vjeç të ardhur vetëm, u jepet përfaqësues i cili kujdeset për të mirën e tyre.

Për shqyrtimin e aplikimit Ti duhet ti dorëzosh dokumentat e udhëtimit (pasaportë apo dokument të ngjashëm) policisë apo kontrollorëve të pasaportës. të cilët ja cojnë ato Zyrës për Imigracion. Në të njëjtën kohë kur të marrësh vendimin do marrësh mbrapsht dhe dokumentat e udhëtimit.

Informacionet personale dhe rruga e udhëtimit

Në fazën e parë të hetimit, kontrollori i pasaportës apo policia të kërkon të plotësosh aplikimin për azil si dhe qartëson informacionet e tua personale dhe rrugën e udhëtimit. Për arsye identifikimi ty të merret fotografi, shenjat e gishtërinjve dhe shenjat e tjera të identifikimit. Gjithashtu, juve do t'ju merren shenjat e secilit prej gishtave të dorës që më vonë të mund të regjistrohen në kartën e lejeqëndrimit që dëshmon lejeqëndrimin.

Ju duhet ta plotësoni formularin e kërkesës për azil duke i bashkëngjitur atij një fotografi që plotëson kriteret e fotografisë për pasaportë. Fotografinë duhet ta dorëzoni në stacionin e policisë kur të shkoni për t'u intervistuar.

Informacionet personale u kërkojnë edhe nga anëtarët e familjes tënde dhe nga të afërmit e tu. Paraqit me saktësi edhe informacionet që kanë të bëjnë me ta. Çështja ka rëndësi më vonë nëse merrni lejen të qëndroni në Finlandë dhe dëshironi edhe familjen tuaj këtu.

Intervista dhe detyrimi shtetëror

Pas zbardhjes së shenjave të identifikimit dhe të rrugës së udhëtimit, ty të thërrasin në Zyrën e Imigracionit ku zyrtari i cili shqyrton çështjen tënde të interviston. Qëllimi i intervistës është të zbardhë shkaqet pse ti kërkon azil. Ty të pyesin ndër të tjera se në çfarë mënyre je trajtuar çnjerëzisht dhe si të janë fyer të drejtat e tua, si shfaqen keto dhunime dhe çfarë provash ke që dëshmojnë këto fakte. Në fund të hetimit përpilohet procesverbali, një kopje e të cilit të jepet edhe ty.

Zyrtarët dhe ndihmësit e tu ligjorë janë të detyruar të ruajnë sekretin shtetëror. Për shkaqe sigurie, informacionet që kanë të bëjnë me azilin mbahen të fshehta. Për këtë arsye, zyrtarët nuk kontaktojnë personelin që përfaqëson shtetin tënd në Finlandë dhe as zyrtarët e shtetit tënd.

SHQYRTIMI NË ZYRËN E IMIGRACIONIT

Pas hetimit të azilkërkimit, Zyra e Imigracionit vazhdon shqyrtimin e aplikimit tënd në bazë të informacionit me shkrim. Gjatë shqyrtimit të çështjes mund ta plotësosh më tej aplikimin tënd.

Zyra e Imigracionit merr vendimin në bazë të të gjitha informacioneve që disponon, të cilat i ka marrë për çështjen tënde. Vendimi bazohet në hetimin e azilkërkimit si dhe në zbardhjen e mëtejshme të fakteve të cilat i ke paraqitur ti vetë apo ata të cilët zyrtarët i kanë kërkuar. Në zgjidhjen e çështjes influencojnë informacionet për vendin tënd dhe për gjendjen e të drejtave të njeriut.

Zyra e Imigracionit trajton aplikimet për azil sipas rendit të mbërritjes. Megjithatë në pozicion të veçantë janë për shembull aplikimet e familjeve me fëmijë dhe të fëmijëve nën 18 vjeç që udhëtojnë pa kujdestar, të cilat shqyrtohen më shpejt.

Për shkak të sigurisë tënde, Zyra e Imigracionit nuk jep informacione lidhur me aplikimin tënd me telefon. Nëse kërkon të plotësosh aplikimin tënd me informacione të reja ose ti ke ndonjë arsye të veçantë për të

përsheptuar shqyrtimin e aplikimit, kontakto me anë të një letre me Zyrën e Imigracionit.

Kur vendimi për aplikimin tënd është marrë, Zyra e imigracionit e dërgon vendimin tek rajoni i policisë së komunës ku ti jeton. Policia ta lexon vendimin dhe siguron një përkthyes nëse është e nevojshme.

Gjatë shqyrtimit të aplikimit tënd mund të lëvizësh lirisht në Finlandë, por nuk mund të udhëtosh jashtë vendit. Nëse largohesh nga Finlanda kur shqyrtimi i aplikimit nuk ka mbaruar, çështja juaj mund të pezullohet.

Leje për të qëndruar në Finlandë

Mund të qëndrosh në Finlandë nëse të jepet azil apo lejeqëndrim.

Ty të jepet azil nëse arsyet që ti ke dhënë e që kanë të bëjnë me rastin tënd janë origjinale dhe përfshijnë besimin fetar, kombësinë dhe përfshirjen në një grup të caktuar shoqëror dhe politik. Nëse merr azil, ti ke statusin e refugjatit në Finlandë.

Edhe në rast se nuk arrini të merrni azil, juve mund t'ju miratohet lejeqëndrim me bazë mbrojtje dytësore. Lejeqëndrimin mund ta merrni nëse në vendin tuaj jeni i kërcënuar me vdekje, nëse jeni i kërcënuar me ekzekutim, ose nëse jeni i kërcënuar nga trajtimi çnjerëzor ose jo dinjitoz për një njeri. Edhe nëse nuk mund të ktheheni në mënyrë të sigurtë në vendin tuaj, për shembull, për shkak të një konflikti të armatosur, atëherë mund të merrni lejeqëndrim.

Nëse nuk ju miratohet kërkesa për azil ose lejeqëndrimi me bazë mbrojtje dytësore, atëherë juve mund t'ju miratohet lejeqëndrim me bazë mbrojtje humanitare. Këtë lejeqëndrim mund ta merrni nëse nuk mund të ktheheni në vendin tuaj për shkak të një katastrofe natyrore ose për shkak të sigurisë së keqe në vend, që mund të jetë e shkaktuar nga një konflikt i armatosur ose nga një situatë e vështirë e të drejtave të njeriut.

Gjatë procesit të azilkërkimit do të shqyrtohet dhe vendoset për mundësinë e marrjes së lejeqëndrimit

- për arsye personale njerëzore
- për parandalimin e largimit të personit nga vendi
- si viktimë e trafikimit të genieve njerëzore.

Nëse dëshironi që t'ju miratohet lejeqëndrimi për ndonjë arsye tjetër, atëherë duhet të plotësoni një formular tjetër për lejeqëndrim dhe të bëni pagesën e procesimit të kërkesës tuaj. Të tjera arsye janë, për shembull, lidhja familjare, puna ose studimet. Megjithatë, Zyra e Imigracionit do t'i shqyrtojë të gjitha kërkesat bashkë dhe vendimet përkatëse lidhur me ato, do t'i merrni njëkohësisht.

Që prej fillimit të vitit 2012 si dëshmi për lejeqëndrimin do të jepet karta e lejeqëndrimit, e cila do të jetë në fuqi për aq kohë sa të jetë lejeqëndrimi. Në çipin e

kartës së lejeqëndrimit do të ruhet fotografia e fytyrës, të dhënat personale dhe shenjat e gishtërinjve. Nëse ju miratohet azili, atëherë do të pajiseni me një dokument udhëtimi për refugjatë.

Nëse aplikimi yt nuk pranohet

Zyra e Imigracionit e refuzon aplikimin tënd, nëse kushtet në vendin tënd janë të tilla që ti nuk ke nevojë për mbrojtje ndërkombëtare. Bashkë me kthimin tënd, të jepet edhe ndalim kalimi, i cili është në fuqi në të gjitha vendet Shengen.

E drejta jote për azil nuk shqyrtohet gjithmonë në Finlandë

Ti nuk ke të drejtë të ankohesh për faktin sesi shteti heton dhe shqyrton aplikimin tënd për azilkërkim. Shtetet e BE-së* si dhe Islanda, Lihtenshtajni, Norevegjia dhe Zvicra kanë rënë dakort për shtetin që është përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës për azil.

Aplikimi për azilkërkim i plotësuar në Finlandë mund ti jepet një shteti tjetër për shqyrtim në raste të tilla kur

- ke kërkuar azil tek ai shtet më parë
- pjesëtarët e familjes tënde janë tek ai vend si refugjatë
- ti disponon një lejeqëndrim apo vizë të atij shteti
- ke hyrë në Finlandë nëpërmjet atij shteti në mënyrë ilegale ose ke shmangur kontrollin kufitar.

Në këto raste, Zyra e Imigracionit nuk e shqyrton aplikimin tënd mbi bazë azilkërkimi por ja kalon atë shtetit përgjegjës apo e kthen personin në fjalë tek ai shtet. Ty mund të të largojnë menjëherë nga Finlanda pasi të kesh marrë njoftimin e vendimit.

*) Vendët anëtare të Bashkimit Evropian përveç Finlandës përfshijnë edhe Vendet e Ulta, Belgjikën, Bullgarinë, Spanjën, Irlandën, Britaninë e Madhe, Italinë, Austrinë, Greqinë, Qipron, Kroacia, Letoninë, Lituanië, Luksemburgun, Maltën, Portugalinë, Poloninë, Francën, Rumaninë, Suedinë, Gjermaninë, Sllovakinë, Çekinë, Danimarkën, Hungarinë dhe Estoninë.

Përsëritja e aplikimit

Nëse kërkon azil në Finlandë në mënyrë të përsëritur dhe situata juaj nuk ka ndryshuar pas vendimeve të mëparshme negative, ti merr sërish përgjigje negative dhe policia mund të të largojë menjëherë nga Finlanda.

Nëse vjen nga një vend i sigurtë

Nëse ti vjen nga një vend i sigurtë, aplikimi yt mund të shqyrtohet me procedurë të përsheptuar. Shtatë ditë pasi Zyra e Imigracionit të ka intervistuar dhe ka përgatitur procesverbalin e intervistës, zyra të jep vendimin negativ për aplikimin tënd si dhe bën gati procedurat për kthimin në atdhe. Tetë ditë pasi të kesh marrë vendimin mbi aplikimin tënd, policia mund të të largojë nga Finlanda.

Aplikimi tërësisht i pabazuar

Ti merr përgjigje negative për aplikimin tënd, nëse ai konsiderohet si tërësisht i pabazuar. Kështu ndodh në raste kur për shembull si bazë për aplikimin tënd shërbejnë shkelje jo të rënda të të drejtave të njeriut apo ke përdorur në mënyrë të gabuar procesin e azilkërkimit. Edhe në këto raste ti merr përgjigje negative dhe policia mund të të largojë nga Finlanda tetë ditë pasi të kesh marrë vendimin mbi aplikimin tënd.

A JE I PAKËNAQUR ME VENDIMIN E ZYRËS SË IMIGRACIONIT?

Nëse je i pakënaqur me vendimin e Zyrës së Imigracionit, që ka të bëjë me azilkërkimin, dhënien e lejeqëndrimit mbi baza të mbrojtjes dytësore apo humanitare, si dhe kthimin në atdhe dhe ndalim ardhjeje, ti mund të apelosh në gjykatën administrative të Helsinkit.

Vendimin e gjykatës administrative të Helsinkit mund ta apelosh sërish tek gjykata administrative e shkallës më të lartë nëse të jepet leja për një gjë të tillë.

Nëse merr përgjigje tërësisht negative në lidhje me aplikimin tënd për azilkërkim (nuk merr as azil as lejeqëndrim) dhe vendimi nuk ndryshon nëpërmjet apelimit, ti duhet të largohesh nga Finlanda.

BANIMI NË QENDRËN E PRANIMIT

Ty të jepet strehim i përkohshëm në qendrën e pranimi ku jeta është falas, nëse nuk ke mundësi të jetosh as ti as familja jote me të ardhurat tuaja. Nëse për shembull shkon në punë, për strehimin merret njëfarë pagese. Mundet të ndodhë edhe që ta ndryshosh strehimin nga një qendër pranimi në një tjetër.

Azilkërkuesit nën moshën 18 vjeç që kanë mbërritur pa kujdestarë, dërgohen në apartamentet e veçanta mbështetëse për grupe të tilla që ndodhen në pjesë të ndryshme të vendit dhe që kanë lidhje me qendrat e pranimi.

Nga qendra e pranimi ti merr çarçafë dhe peshqira, një paketë me ushqime si dhe sende të tjera thelbësore për jetën e përditshme. Pas kësaj, ti duhet ta blesh dhe ta përgatisësh vetë ushqimin, në rast se qendra e pranimi nuk ofron ushqimin. Nëse nuk mundesh ta përballosh jetesën për veten dhe familjen tënde në Finlandë, qendra e jote e pranimi mund të të japë ndihmën finan-ciare të mirëseardhjes. Fëmijët në moshë të mitur, që kanë ardhur pa kujdestarë të tyre, do të marrin ndihmën e plotë financiare.

Nëse ke ardhur në Finlandë vetëm, ti e ndan dhomën me njerëzit e të njëjtës gjini. Familjeve përpqemi tu japim një hapësirë të përbashkët banimi.

Rregullat dhe zakonet e mira

Si banor i qendrës së pranimi ti duhet të ndjekësh rregullat dhe udhëzimet e sigurisë të qendrës ku caktohen ndër të tjera koha e vizitave, e qetësisë gjatë natës, e sigurisë ndaj zjarrit dhe e pirjes së duhanit. Secili banor e përgatit vetë ushqimin, në rast se qendra e pranimi nuk ofron ushqim, si dhe e pastron vetë dhomën e tij. Në shumë qendra pranimi, banorët janë përgjegjës edhe për pastrimin e hapësirave të përbashkëta.

Tepër e rëndësishme është të merret parasysh se në qendrën e pranimi banojnë njerëz të kulturave të ndryshme dhe secili respekton zakonet e tjetrit.

Guida dhe shërbimet shëndetësore

Punonjësit e qendrës së pranimi të familjarizojnë me zakonet e shtëpisë si dhe të udhëzojnë për vajtjen në dyqan si dhe në gjëra të tjera. Por punonjësit nuk mund të influencojnë në shpejtësinë e shqyrtimit të aplikimit tënd për azilkërkim apo në brendësinë e vendimit të këtij aplikimi. Nëse ti nuk ke një gjuhë të përbashkët me punonjësit, ty të jepet si ndihmë një përkthyes.

Ti mund ti nënshtrohesh kontrollit shëndetësor sapo të mbërrish në qendrën e pranimi. Nëse është e nevojshme, mund të takohesh me mjekun dhe në bazë të rekomandimeve të mjekut mund të marrësh ndihmë spitalore. Për probleme të ndryshme, ti merr ndihmë në formë bisede nga punonjësi social, i cili shqyrton se çfarë shërbimesh do të ishin të nevojshme për ty. Nëse ti ke të ardhura, ty të merret njëfarë pagesë kundrejt shërbimit shëndetësor. Nëse mjeku që të kontrollon e cilëson trajtimin mjekësor si të panevojshëm, ti duhet ta paguash vetë këtë të fundit.

Aktiviteti i punës dhe ai shkollor

Qendra e pranimi mund të organizojë aktivitete të punës si dhe aktivitete shkollore. Të gjithë personat e moshës 16-64 vjeç, janë të detyruar të marrin pjesë në to, përveç rasteve kur sëmundja apo ndonjë shkak tjetër bëhet pengesë.

Aktivitet pune mund të jetë për shembull pastrimi i qendrës së pranimi, riparimet si dhe punët e oborrit, përfshirë këtu edhe detyrat ndihmëse në komunë. Në aktivitetet shkollore përfshihen ndër të tjera studimi i gjuhës finlandeze apo i asaj suedeze, njohja e shoqërisë finlandeze dhe mësimi i njohurive kompjuterike. Ti mund të mësosh edhe jashtë qendrës së pranimi, për shembull nëpërmjet kurseve të zyrës së punësimit apo kolegjit civil.

Banori i qendrës së pranimi dhe punonjësit planifikojnë së bashku në cilat aktivitete banorët do të marrin pjesë. Nëse e refuzon vazhdimisht pjesëmarrjen në aktivitetet e punës dhe në ato shkollore, qendra e pranimi mund ta pakësojë me 20 përqind ndihmën financiare të mirëseardhjes që ju pagohet, maksimumi deri në dy muaj.

BANIMI JASHTË QENDRËS SË PRANIMIT

Ti mund të transferohesh edhe tek të afërmit apo miqtë e tu, por atëherë ti duhet ti përballosh vetë shpenzimet e jetesës. Kur jeton në banesë private, ti duhet ti paraqesësh qendrës së pranimi kontratën e qerasë apo ndonjë tjetër raport mbi jetesën tënde si dhe duhet të njoftosh adresën tënde me shkrim.

Nëse nuk ke jetuar më parë në një qendër pranimi, ti duhet të regjistrohesh tek qendra e pranimi më e afërt si banues i saj.

Në qendrën e pranimi jetohej përkohësisht. Nëse ty të jepet lejeqëndrimi, ti duhet ta gjesh banesën për veten tënde sa më shpejt të jetë e mundur. Punonjësit e qendrës së pranimi do të ndihmojnë në gjetjen e banesës. Nëse siguron azil ose për shembull lejeqëndrim mbi bazën e mbrojtjes dytësore apo humanitare, ty të jepet banesë nga komuna që të merr në përfshirje.

TË DREJTAT DHE DETYRIMET

Ndihma ligjore

Ti mund të përdorësh ndihmës ligjor apo avokat gjatë intervistës për azilkërkim apo gjatë apelimit për vendimin që ka të bëjë me këtë aplikim. Ndihmë ligjore të japin zyrat e ndihmës ligjore dhe zyrat e tjera të avokatisë dhe avokatët, të cilët kanë njoftuar qendrën e pranimi për të qenit të disponueshëm në dhënien e ndihmës ligjore për azilkërkuesit. Informacione të mëtejshme mbi ndihmesat ligjore të zonës mund të merrni nga punonjësit e qendrës së pranimi.

Trajtimi profesional dhe mbrojtja e intimitetit

Në kushtetutën e Finlandës ka rregullore që kanë të bëjnë me azilkërkuesit. Punonjësit e qendrës së pranimi nuk u tregojnë të tjerëve sekrete që kanë të bëjnë me çështje private si dhe ata nuk dëgjojnë bisedat e tua telefonike dhe nuk hapin letrat e tua pa lejen tënde. Vetëm në raste të kujdesit të banesës apo për shembull në rast rënie zjarri, në dhomën tënde mund të hyhet pa dëshirën tënde.

Kryerja e punës

Azilkërkuesi ka të drejtë të kryejë punë me rrogë në Finlandë pa lejeqëndrimi, pasi të kenë kaluar tre muaj nga lënia e kërkesës për azil, nëse ai ka dokument udhëtimi në fuqi, me të cilin ka të drejtë të kalojë kufirin. Nëse azilkërkuesi nuk ka dokument të tillë, atëherë azilkërkuesi ka të drejtë të kryejë punë me rrogë në Finlandë pa lejeqëndrimi, pasi të ketë banuar gjashtë muaj këtu.

Vajtja në shkollë

Fëmija i azilkërkuesit ka të drejtë të shkojë në shkollë. Shkolla fillohet në moshën 6 vjeçare me mësimin parashkollor në çerdhe apo në shkollën fillore. Fëmijët e moshës 7-16 vjeç e marrin mësimin bazë nga shkolla fillore.

Në fillim fëmijët mësojnë finlandisht ose suedisht. Mësimi dhe librat shkollorë janë falas. Prindërit dhe shkolla mbajnë kontakte të vazhdueshme. Nëse fëmija nuk mund të shkojë në shkollë për shembull për arsye shëndetësore, mësuesit duhen lajmëruar për këtë gjë.

Ndalohen substancat dhe sendet e rrezikshme

Në qendrën e pranimi është e ndaluar të mbahen substanca dhe sende të rrezikshme, si për shembull, droga dhe armë. Personeli i qendrës së pranimi mund të bëjë kontroll në dhomë, nëse dyshon që banori ka në zotërim substanca ose sende të rrezikshme. Në raste të tjera, hyrja në dhomë pa pëlqimin e banorit bëhet vetëm kur bëhet mirëmbajtja e banesës ose, për shembull, në rast zjarri.

Detyrimi për regjistrim

Policia apo zyrtari kufitar mund të të caktojë një detyrim për tu regjistruar dhe të kërkojë se ku mund të të kontaktojë. Nëse nuk e ndjek këtë detyrim ty mund të të vënë gjobë.

Njoftimi i adresës tek qendra e pranimi

Nëse kërkon banesë më vete, ti duhet të njoftosh qendrën e pranimi për adresën tënde të re dhe ndryshimet e adresës. Nëse adresa e vërtetë nuk është në dispozicion të qendrës së pranimi, atëherë ndihma financiare e mirëseardhjes nuk mund të të paguhet. Edhe kur të largohesh për ndonjë vizitë ti duhet të njoftosh sesi mund të kontaktohesh.

INFORMACIONE KONTAKTI

Maahanmuuttovirasto (Zyra e Imigracionit)

Lautatarhankatu 10
PL 18
00581 Helsinki
tel. 0295 419 600
Numri për shërbime
në këtë çështje: 0295 419 627 nga e marta deri të
enjten në ora 10 - 11

Vähemmistövaltuutetun toimisto

(Zyra e përgjegjësit të minoriteteve)

PL 26
00023 Valtioneuvosto
Adresa: Mikonkatu 25, Helsinki
Numri i tel.për shërbimin e klientëve: 071 878 8666
ofm@ofm.fi

Kidutettujen kuntoutuskeskus

(Qendra e rehabilitimit të të torturuarve)

Helsingin Diakonissalaitos
Mäkelänkatu 58–60
00510 Helsinki
tel. (09) 7750 4584
kitu@hdl.fi

Suomen Mielenterveysseura

(Shoqata e Finlandës për Shëndetin mendor)

SOS-kriisikeskus (Qendra për kriza SOS)

Maistraatinportti 4 A, 4. krs
00240 Helsinki
tel. (09) 4135 0510
sos-keskus@mielenterveysseura.fi

YK:n pakolaisiain päävaltuutetun lähin aluetoimisto

(Zyra më e afërt e të ngarkuarit të OKB-së për çështjet e refugjatëve)

UNHCR

Ynglingagatan 14, 6 tr
S-113 47 Stockholm
Sverige
tel. +46 8 457 48 80
seest@unhcr.org

Työsuojelupiirit (Qarqet e sigurisë në punë)

informacione kontakti në www.tyosuojelu.fi